

**AKTI I THEMELIMIT I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Sunlight E&E” shpk**

Sot, Më datë 27/04/2022, shoqëria krijohet nga ortaku i vetëm themelues:

Limoza Metaj, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal H25217090M, i datëlindjes 17/02/1972, lindur në Lezhan dhe banuese në Vlorë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 1:
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “Sunlight E&E” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike solare (fotovoltaikë, energjisë së erës (eolike) dhe energjisë gjeotermale në Republikën e Shqipërisë dhe marja nga Qeveria Shqiptare apo Ministri e Institucioneve të shtetit shqiptar i të gjitha miratimeve, lejeve dhe licencave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyre të qetë dhe në perputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë si dhe shërbime të tjera të ngjashme ose të lidhura me sa me sipër të cilat nuk ndalohen me ligj në Shqipëri dhe çdo lloj veprimtarie të ligjshme.

- 2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga Zhan D'Ark , Ndërtesa 18, Nr.ap 41, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.



Neni 5:
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqindmijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë dhe nuk është paguar. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Znj.Limoza Metaj: Zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 lekë që përben 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 2) Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6:
Administratori

- 1) Administratore e shoqërisë emërohet Znj.Limoza Metaj, shtetase shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal H25217090M e datëlindjes 17/02/1972, lindur në Lezhan dhe banuese në Vlorë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emëritimit.

Neni 7:
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e tij ne përputhje te plotë me ketë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 8:
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njoitura nga ligji.

**ORTAKËT E SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Sunlight E&E” shpk**

Limoza Metaj
(Emër, Mbiemër, Firma)



Faqe 2 e 2
Akti i Themelimit
Sunlight E&E shpk